



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.52

5 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 403 datë 24.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes, me shkëmbim notash, për korrigjimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe evazionit fiskal, për taksat mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, nënshkruar më 6 prill 2010 në Berlin 2199
Ligj nr.10 412 datë 7.4.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ujësjellës-Kanalizime, Pogradec, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet, Pogradec III” 2201

LIGJ
Nr.10 403, datë 24.3.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES, ME SHKËMBIM NOTASH,
PËR KORRIGJIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË
DYFISHTË DHE EVAZIONIT FISKAL, PËR TAKSAT MBI TË ARDHURAT DHE MBI
KAPITALIN”, NËNSHKRUAR MË 6 PRILL 2010 NË BERLIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja, me shkëmbim notash, për korrigjimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe evazionit fiskal, në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, nënshkruar më 6 prill 2010 në Berlin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6967, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

Notë verbale nr.148/2010

NOTË VERBALE

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë i paraqet nderimet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin të propozojë lidhjen e një marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi korrigjimin e Marrëveshjes së nënshkruar më datë 6 prill 2010 në Berlin ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin (në vijim: “Marrëveshja”). Propozohet që teksti i korrigjuar të jetë si më poshtë:

1. Teksti në gjuhën gjermane i nenit 23, paragrafi 1, germa “b”, germa e dyfishtë “ee” e Marrëveshjes të zëvendësohet me:

“Einkünfte, die nach nummer 5 des angefügten Protokolls in Albanien besteuert werden können;”

2. Teksti në gjuhën shqipe i nenit 23, paragrafi 1, germa “b”, germa e dyfishtë “ee” e Marrëveshjes të zëvendësohet me:

“zërat e të ardhurave, që mund të taten në Shqipëri sipas pikës 5 të Protokollit të bashkëlidhur;”

3. Teksti në gjuhën angleze i nenit 23, paragrafi 1, germa “b”, germa e dyfishtë “ee” e Marrëveshjes të zëvendësohet me:

“items of income that may be taxed in Albania according to number 5 of the attached protocol;”

4. Tekstet e korrigjuara do t'i zëvendësojnë tekstet e gabuara me prapaveprim duke filluar nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes.

5. Kjo Marrëveshje lidhet në gjuhën gjermane, shqipe dhe angleze, duke qenë të tria tekstet autentike (të barasvlershme). Në rast mosmarrëveshjesh në interpretimin e teksteve në gjuhën gjermane dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Përveç kësaj, Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë propozon që, në rast se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë shprehet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 5, kjo notë dhe nota e përgjigjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilën shprehet pëlqimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të përbëjnë një marrëveshje, e cila hyn në fuqi së bashku me Marrëveshjen.

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë përfiton nga rasti për t'ia siguruar sërish Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë konsideratën e saj më të lartë.

Tiranë, më 17 nëntor 2010.

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë i paraqet komplimentet e saj Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë dhe ka nderin që, në vijim të notës së asaj Ambassade nr. RK 551.20 ALB, datë 17 nëntor 2010 (VN-Nr.: 148/2010), e cila citon si më poshtë:

“Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë i paraqet nderimet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin të propozojë lidhjen e një marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi korrigjimin e Marrëveshjes së nënshkruar më datë 6 prill 2010 në Berlin ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për shamngien e tatimit të dyfishtë në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin (në vijim: “Marrëveshja”). Propozohet që teksti i korrigjuar të jetë si më poshtë:

1. Teksti në gjuhën gjermane i nenit 23, paragrafi 1, germa “b”, germa e dyfishtë “ee” e Marrëveshjes të zëvendësohet me:

“Einkünfte, die nach nummer 5 des angefügten Protokolls in Albanien besteuert werden können;”

2. Teksti në gjuhën shqipe i nenit 23, paragrafi 1, germa “b”, germa e dyfishtë “ee” e Marrëveshjes të zëvendësohet me:

“zërat e të ardhurave, që mund të taten në Shqipëri sipas pikës 5 të Protokollit të bashkëlidhur;”

3. Teksti në gjuhën angleze i nenit 23, paragrafi 1, germa “b”, germa e dyfishtë “ee” e Marrëveshjes të zëvendësohet me:

“items of income that may be taxed in Albania according to number 5 of the attached protocol;”

4. Tekstet e korrigjuara do t'i zëvendësojnë tekstet e gabuara me prapaveprim duke filluar nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes.

5. Kjo Marrëveshje lidhet në gjuhën gjermane, shqipe dhe angleze, duke qenë të tria tekstet autentike (të barasvlefshme). Në rast mosmarrëveshjesh në interpretimin e teksteve në gjuhën gjermane dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Përveç kësaj, Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë propozon që, në rast se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë shprehet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 5, kjo notë dhe nota e përgjigjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilën shprehet pëlqimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të përbëjnë një marrëveshje, e cila hyn në fuqi së bashku me Marrëveshjen.

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë përfiton nga rasti për t'ia siguruar sërish Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë konsideratën e saj më të lartë”.

dhe të konfirmojë pëlqimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për sa është propozuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë përfiton edhe njëherë nga rasti për t'i përsëritur Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë sigurimet e konsideratës së saj më të lartë.

Tiranë, më 31 dhjetor 2010

Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, Tiranë

LIGJ

Nr.10 412, datë 7.4.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE UJËSJELLËS-KANALIZIME, POGRADEC, SI AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “MBROJTJA MJEDISORE E LIQENIT TË OHRIT, KANALIZIMET, POGRADEC III””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ujësjellës-Kanalizime, Pogradec, si agjenci e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Mbrotja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet, Pogradec III””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6978, datë 20.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE HUAJE

**NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (HUAMARRËS) DHE UK
POGRADEC (AGJENCI E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 10 MILIONË EURO (HUAJA)**

**- PROGRAMI I MBROJTJES SË AMBIENTIT, LIQENI I OHRIT, KANALIZIMET POGRADEC
- FAZA III**

Preambulë

Baza për këtë marrëveshje huaje është marrëveshja që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (FC) (marrëveshja qeveritare).

KfW-ja do të rifinancojë huan e dhënë në pajtim me termat dhe dispozitat e kësaj marrëveshjeje nga fondet e veta, si dhe nga fondet e buxhetit me interes të ulët të dhënë nga

Republika Federale e Gjermanisë për projektet që përmbushin standardet e politikës së zhvillimit për projekte të përshtatshme. Termat dhe kushtet e huas përputhen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje huaje për njohjen si asistencë zyrtare për zhvillimin (ODA).

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon një total prej 10 milionë euro.

1.2 Qëllimi. Huamarrësi e kanalizon huan tek agjencia e zbatimit të projektit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit e përdor huan vetëm për të financuar: a) zëvendësimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve dhe strukturën e rezervuarëve septike; b) zgjerimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza; dhe c) zëvendësimi dhe zgjerimi i sistemit të furnizimit me ujë sipas projektit të programit për mbrojtjen e ambientit liqeni i Ohrit, kanalizimet Pogradec (faza III (projekti)). Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë për të cilën do të blet dakord me Huamarrësin.

1.3 Tatimet, detyrimet, detyrimet doganore. Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi, ose agjencia e zbatimit të projektit, si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga huaja.

2. Kanalizimi i huas tek agjencia e zbatimit të projektit

2.1 Marrëveshja e kanalizimit. Përveç kur bihet dakord ndryshe sipas një politike të re të Qeverisë së Shqipërisë, Huamarrësi e kanalizon huan e përcaktuar në euro tek agjencia e zbatimit të projektit sipas marrëveshjes së veçantë të huas për një afat prej 40 vjetësh duke përfshirë një periudhë pa shlyerje prej 10 vjetësh. Interesi nuk kalon shumën e përgjithshme të interesit që rrjedh nga neni 5.1.

2.2 Përkthimi i certifikuar. Para disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht për marrëveshjen e kanalizimit të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Mosekzistenca e detyrimit për agjencinë e zbatimit të projektit. Kanalizimi i huas nuk përbën ndonjë detyrim për agjencinë e zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje huaje.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesa për disbursim. Menjëherë sapo të përmbushen kushtet paraprake për disbursimin në pajtim me nenin 3.4, KfW-ja disburson huan në pajtim me përparimin e projektit me kërkesën e agjencisë së zbatimit të projektit.

3.2 Marrëveshje e veçantë. Në një marrëveshje të veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton procedurën e disbursimit, veçanërisht provat që duhet të jepen nga agjencia e zbatimit të projektit që provon që shumatat e kërkuara të huas përdoren për qëllimin parashikuar në këtë marrëveshje. Marrëveshja e veçantë duhet të miratohet nga huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

3.3 Afati i fundit për kërkimin e disbursimeve. KfW-ja ka të drejtën të refuzojë disbursimet pas datës 31 dhjetor 2015.

3.4 Kushtet paraprake të disbursimit. KfW-ja duhet të bëjë disbursime sipas kësaj marrëveshjeje huaje vetëm nëse:

a) Huamarrësi ka dhënë prova të pranueshme për KfW-në që ai ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjeve të tij kushtetuese dhe të tjera për prezumimin e vlefshëm të të gjithë detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje;

b) Nënshkrimet ekzemplare të përmendura në nenin 13.1 (përfaqësimi i Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit) i janë paraqitur KfW-së;

c) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 është në fuqi pa asnjë kufizim;

d) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përmendur në nenin 4.2;

e) Nuk kanë ndodhur raste të mosplotësimit të detyrimeve;

f) Nuk kanë ndodhur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

g) Provat e kërkuara në pajtim me klauzolën 10.4 (përjashtimi nga tatimet) është paraqitur;

h) Një përkthim i certifikuar i marrëveshjes së kanalizimit në pajtim me klauzolën 2.2 është paraqitur;

i) Agjencia e zbatimit të projektit do të ketë demonstruar duke paraqitur të gjithë dokumentet e kërkuara që kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta për zbatimin) janë përmbushur;

Para disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë ato dokumente dhe prova të tjera që ajo i konsideron të nevojshme.

3.5 Heqja dorë nga disbursimi. Në pajtim me përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të huas me pëlqimin e KfW-së në këmbim të pagesës së kompensimit në pajtim me klauzolën 3.6.

3.6 Kompensimi. Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume huaje, ose nëse një shumë huaje nuk disbursohet fare ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në klauzolën 3.3 për shkaqe të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të bëhet përgjegjëse, Huamarrësi, jo më vonë se 10 ditë pune nga kërkesa e parë, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është normalisht e arsyeshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së huas në fjalë.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e angazhimit. Huamarrësi paguan një tarifë përkushtimi të pakthyeshme prej 0.25% p.a. për shumat e padisbursuara të huas. Tarifa e përkushtimit llogaritet për periudhën që fillon me kalimin e periudhës tremujore pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe që vazhdon derisa huaja është disbursuar plotësisht. Është e kërkueshme të paguhet dy herë në vit në fund të periudhës më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila “data e pagesës”). Bëhet për herë të parë e pagueshme më 30 qershor 2011.

4.2 Tarifa e menaxhimit. Huamarrësi i paguan KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1.0% të shumës kryesore të huas së caktuar në nenin 1.1. Tarifa e menaxhimit bëhet e kërkueshme pas kalimit të periudhës tremujore pasi kjo marrëveshje huaje të ketë hyrë në fuqi për KfW-në. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, tarifa e menaxhimit mbledhet plotësisht pavarësisht nëse huaja disbursohet plotësisht apo jo.

5. Interesi

5.1 Interesi (norma fikse e interesit e caktuar mbi dhënien e huas) Huamarrësi paguan normë interesi mbi huan me një normë prej 3% p.a. (normë fikse interesi) deri në marrjen e këstit të fundit të shlyerjes sipas grafikut të Shlyerjes sipas përcaktimit në nenin 6.1.

5.2 Llogaritja e interesit dhe datat e pagesës së interesit. Interesi për një shumë të disbursuar të huas do të ngarkohet me interes nga data (duke përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e huas paguhet nga llogaria e huas që mbahet te KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë), në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3. Interesi llogaritet në pajtim me nenin 7.1 (llogaritja). Interesi paguhet në fund të periudhës në datat e pagesave (sipas përcaktimit në nenin 4.1).

6. Shlyerja e parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi e shlyen huan si më poshtë:

Kësti	Datë		Shuma	
1	qershor 30	2014	250.000,00	Euro
2	dhjetor 30	2014	250.000,00	Euro
3	qershor 30	2015	250.000,00	Euro
4	dhjetor 30	2015	250.000,00	Euro
5	qershor 30	2016	250.000,00	Euro

6	dhjetor 30	2016	250.000,00	Euro
7	qershor 30	2017	250.000,00	Euro
8	dhjetor 30	2017	250.000,00	Euro
9	qershor 30	2018	250.000,00	Euro
10	dhjetor 30	2018	250.000,00	Euro
11	qershor 30	2019	250.000,00	Euro
12	dhjetor 30	2019	250.000,00	Euro
13	qershor 30	2020	250.000,00	Euro
14	dhjetor 30	2020	250.000,00	Euro
15	qershor 30	2021	250.000,00	Euro
16	dhjetor 30	2021	250.000,00	Euro
17	qershor 30	2022	250.000,00	Euro
18	dhjetor 30	2022	250.000,00	Euro
19	qershor 30	2023	250.000,00	Euro
20	dhjetor 30	2023	250.000,00	Euro
21	qershor 30	2024	250.000,00	Euro
22	dhjetor 30	2024	250.000,00	Euro
23	qershor 30	2025	250.000,00	Euro
24	dhjetor 30	2025	250.000,00	Euro
25	qershor 30	2026	250.000,00	Euro
26	dhjetor 30	2026	250.000,00	Euro
27	qershor 30	2027	250.000,00	Euro
28	dhjetor 30	2027	250.000,00	Euro
29	qershor 30	2028	250.000,00	Euro
30	dhjetor 30	2028	250.000,00	Euro
31	qershor 30	2029	250.000,00	Euro
32	dhjetor 30	2029	250.000,00	Euro
33	qershor 30	2030	250.000,00	Euro
34	dhjetor 30	2030	250.000,00	Euro
35	qershor 30	2031	250.000,00	Euro
36	dhjetor 30	2031	250.000,00	Euro
37	qershor 30	2032	250.000,00	Euro
38	dhjetor 30	2032	250.000,00	Euro
39	qershor 30	2033	250.000,00	Euro
40	dhjetor 30	2033	250.000,00	Euro

6.2 Shumat e padisbursuara të huas. Shumat e padisbursuara të huas do të kompensohen kundrejt këstit përkatës të fundit të shlyerjes në pajtim me grafikun e shlyerjes, përveç kur KfW-ja vendos një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta pas njoftimit paraprak të Huamarrësit.

6.3 Disbursimet pas fillimit të shlyerjes. Nëse shumat e huas disbursohen pasi të ketë filluar shlyerja, Grafiku i Shlyerjes sipas renditjes në nenin 6.1 mbetet i paprekur për sa kohë kësti përkatës i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shumat e huas tashmë të disbursuara. Nëse kësti i shlyerjes i kërkueshëm për pagesa e kalon shumën e pakthyer të huas, KfW-ja zbret shumën e barabartë me diferencën nga kësti i kërkueshëm i shlyerjes, e pjesëton atë me mbetësin e kësteve të shlyerjes të pakthyer dhe ia shton këtë shumë secilit këst të pakthyer të shlyerjes. KfW-ja rezervon të drejtën të shtyjë marrjen në shqyrtim të disbursimeve që bëhen brenda 2204

45 ditëve para datës përkatëse të pagesës për përcaktimin e shumës së pakthyer të huas deri në datën e parafundit të pagesës.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë zbatohet për shlyerjet e parakohshme:

a) E drejta për të bërë parapagesa. Huamarrësi, në pajtim me nënparagrafët a) deri f) më poshtë, mund të shlyejë plotësisht ose pjesërisht huan para maturimit, por të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me klauzolën 6.1.

b) Njoftim. Një parapagim i një shume huaje i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së jo më vonë se dita bankare e pesëmbëdhjetë në Frankfurt mbi Main para datës së përcaktuar të parapagimit. Ky njoftim është i përvokueshëm; ai duhet të përcaktojë datën në të cilën do të bëhet parapagimi dhe shuma e tij që detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) Parapagimi i detyrueshëm. Huamarrësi duhet të rimbursojë menjëherë KfW-në me kërkesë të saj për çdo shumë që Huamarrësi nuk është në gjendje që është përdorur për qëllimin e rënë dakord.

d) Shumat e kërkueshme. Huamarrësi paguan, gjithashtu, shumat e mëposhtme së bashku me parapagesën:

aa) çdo kompensim parapagese të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në pajtim me nenin 6.4 e); dhe

bb) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e parapaguar të huas deri në datën e parapagimit.

e) Kompensimi i parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë huaje para maturimit, Huamarrësi, brenda 10 ditëve pune, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është normalisht e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuara nga KfW-ja si rezultat i parapagimit. KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të parapagimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

f) Kompensimi. Neni 6.2 (shumat e padisbursuara të huas) zbatohen *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 Grafiku i rishikuar i shlyerjeve. Në rastin kur zbatohet neni 6.3 (disbursimet pas fillimit të shlyerjes) ose neni 6.4 (parapagimi), KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që bëhet një pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje dhe zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e përkushtimit, interesi i munguar në pajtim me nenin 7.5, kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 7.6, kompensimi në pajtim me klauzolën 3.6 dhe kompensimi i parapagimit në pajtim me klauzolën 6.4e do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë me muaj me 30 ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që bëhet në lidhje me këtë marrëveshje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë bankare, Huamarrësi duhet ta bëjë këtë pagesë në ditën bankare pasuese. Nëse dita pasuese bankare bie në muajin kalendarik pasues, pagesa përkatëse bëhet në ditën pararendëse bankare.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë marrëveshje nëse dhe menjëherë sapo shumat përkatëse t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në Euro dhe jo më vonë se ora 10:00 para dite në Frankfurt mbi Main në llogarinë e KfW-së që mbahet nga KfW-ja, Frankfurt mbi Main, (kodi bankar 500 204 00, BIC KFWIDEFF me referencë shtesë "Ref. 3102560801") ose në një llogari tjetër që njoftohet nga KfW-ja.

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj marrëveshjeje, përveç kur këto të drejta njihen me vendim përfundimtar deklarativ (*rechtskräftig festgestellt*) dhe nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 Interesi i munguar. Nëse një këst shlyerjeje ose një parapagesë në pajtim me nenin 6.4 (parapagim) nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa paralajmërim,

mund të ngarkojë interes me një normë bazë plus 3% për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3. Kjo normë duhet të paktën të jetë e barabartë me normën e interesit në pajtim me klauzolën 5.1 (interesi). “Norma bazë” është norma e interesit e njoftuar nga Banka Qendrore Gjermane (*Deutsche Bundesbank*) si norma bazë që mbizotëron në datën përkatëse të kërkueshme. Ky interes i munguar bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve pune.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të atyre kësteve të shlyerjeve dhe parapagesave të përmendura në nenin 7.5 (interesi i munguar) KfW-ja, pa paralajmërim, mund të kërkojë kompensim me shumë të plotë me një normë prej 3% mbi normën bazë të zbatueshme në datën përkatëse të kërkueshme për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën e pagesës së këtyre shumave të prapambetura. Kompensimi me shumë të plotë bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve pune. Huamarrësi është i lirë të provojë që faktikisht nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën e përcaktuar.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtën të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Në këtë rast, Huamarrësi do të informohet menjëherë nga KfW-ja.

8. Garancia nga Republika Federale Gjermane

KfW-ja do të marrë garanci nga Republika Federale Gjermane për pretendimet e pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje para disbursimit të parë.

9. Pengu negativ dhe *pari passu*

9.1 Asetet e projektit. As Huamarrësi dhe as agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të rëndojnë me peng, hipotekë apo të krijojnë barrë të tjera apo shesin sendet pasurore të projektit para shlyerjes së plotë të huas pa pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 *Pari passu*. Në masën që lejohet nga ligji, Huamarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje *pari passu* me të gjitha detyrimet e saj ekzistuese ose të ardhme për pagesë, të pasiguruara dhe të pavarura.

10. Kostoja dhe detyrimet publike

10.1 Ndalimi i zbritjeve ose mbajtjeve. Huamarrësi bën të gjitha pagesat sipas kësaj marrëveshjeje pa asnjë zbritje për tatimet, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin që Huamarrësi është i detyruar me ligj ose shkaqe të tjera të bëjë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, pagesat e bëra nga Huamarrësi rriten me ato shuma që janë të nevojshme me qëllim që KfW-ja të marrë plotësisht shumat e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje pas zbritjes së tatimeve dhe detyrimeve.

10.2 Kostoja. Huamarrësi mbulon të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin e huas, veçanërisht koston e dërgimit dhe transferimit (duke përfshirë tarifën e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje huaje.

10.4 Përjashtimi nga tatimi. Para disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi i jep prova KfW-së (për shembull në mendimin ligjor) që provojnë se KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet, interesi, komisionet dhe detyrimet e ngjashme në Shqipëri gjatë dhënies së huas.

11. Detyrime të veçanta

11.1 Zbatimi i programit dhe informacioni i veçantë. Agjencia e zbatimit të projektit do të:

a) Përgatisë, zbatojë, operojë dhe mbajë projektin në pajtim me praktikën e shëndosha financiare dhe teknike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) Ngarkojë me përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit konsulentët inxhinierë të kualifikuar dhe të pavarur, dhe me zbatimin e projektit firma të kualifikuara;

c) Japë kontrata për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja me ofertim konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) Sigurojë financimin e plotë të projektit dhe i jep KfW-së me kërkesë të saj prova që provojnë që kostoja që nuk paguhet nga kjo hua është e mbuluar;

e) Mbajë libra dhe regjistra që tregojnë qartësisht koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe identifikon qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja;

f) Japë mundësi përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me zbatimin dhe operimin e projektit, dhe për të vizituar projektin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

g) Japë KfW-së çdo informacion dhe regjistër i tillë mbi projektin dhe zbatimin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së;

h) Menjëherë dhe me iniciativë të vet:

aa) vë në dijeni KfW-në për çdo pyetje të marrë nga Huamarrësi prej OECD-së ose anëtarët e tij sipas së ashtuquajturës “Marrëveshje për transparencën e kredive ODA të bashkuara” pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe bashkërendon përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në, dhe

bb) njofton KfW-në për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin dhe qëllimin e projektit.

11.2 Marrëveshje e veçantë. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton hollësitë e nenit 11.1 me marrëveshje të veçantë, miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

11.3 Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

aa) siguron financim të plotë të projektit dhe, me kërkesë, i jep KfW-së prova që provojnë që Kostot që nuk mbulohen nga kjo hua janë të mbuluara;

bb) me iniciativë të vet, informon menjëherë KfW-në (i) për ndodhinë ose ndodhinë potenciale të një rasti të mosplotësimit të detyrimeve dhe (ii) për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit; dhe

cc) asiston agjencinë e zbatimit të projektit në pajtim me praktikat e shëndosha inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe projekti dhe, veçanërisht, i jep agjencisë së zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

11.4 Respektimi. Huamarrësi siguron që personat të cilëve ai u beson përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e kontratës për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen, dhe kërkimin e shumave të huas nuk kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë apo pranojnë premtimin e pagesave të paligjshme ose avantazheve të tjera në lidhje me këto detyra.

11.5 Transporti i mallrave. Dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen qeveritare do të zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga huaja.

12. Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

12.1 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve. KfW-ja mund të pushojë huan plotësisht ose pjesërisht, nëse:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose të marrëveshjes së financimit ose projektit të datës @ ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj marrëveshjeje, ose marrëveshjes së financimit ose projektit janë shkelur;

c) Kjo marrëveshje ose çdo pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues mbi Huamarrësin ose pushon së qeni e ekzekutueshme ndaj Huamarrësit;

d) Huamarrësi nuk është në gjendje të provojë që shumat e huas janë përdorur për qëllimet e parashikuara;

e) Nëse ngjarja e mëposhtme ndodh në lidhje me Huamarrësin: fillimi i bisedimeve me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit (me përjashtim të KfW-së) mbi heqjen dorë nga borxhet e prapambetura ose shtyrje pagese; ose

f) Ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e kësaj huaje, ose përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje huaje.

12.2 Pasojat ligjore të rastit të mosplotësimit të detyrimeve. Nëse një prej rasteve të përmendura në nenin 12.1 ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë marrëveshje ose çdo pjesë të saj me pasojën që:

a) Detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje pushojnë; dhe

b) KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e plotë ose të pjesshme të shumës së prapambetur të huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje, klauzola 6.5 (Interesi i munguar) dhe 6.6 (kompensimi me shumë të plotë) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Në rastin kur huaja zgjidhet plotësisht ose pjesërisht para se të jetë shlyer plotësisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin në pajtim me klauzolën 3.6 dhe/ose kompensimin e parapagimit në pajtim me klauzolën 6.4 e.

13. Përfaqësimi dhe deklaratimet

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit. Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e marrëveshjes. Drejtori dhe ata persona që janë caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizuar nga nënshkrimet e ekzemplarëve të vërtetuar prej tij ose saj do të përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të projektit në zbatim të kësaj marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon nëse revokimi shprehimisht prej përfaqësuesit të Huamarrësit të autorizuar në momentin përkatës nuk merret prej KfW-së.

13.2 Komunikimi dhe adresat. Njoftimet dhe deklaratimet në lidhje me këtë marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinale ose – me përjashtim të kërkesave për disbursime – me faks. Të gjitha njoftimet dhe deklaratimet e tjera të bëra në lidhje me këtë marrëveshje huaje duhet të dërgohen tek adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:

KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Germany
Fax: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit” nr.1
Tirana
Republika e Shqipërisë
Fax: +355-42-228494

Për agjencinë e zbatimit të projektit:

Ujësjiellës-Kanalizime
UK Pogradec sh.a.
Rruga e Buçimasit
Pogradec
Albania
Fax: + 355 868-20234

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë bankare. Nëse bëhet referencë në këtë marrëveshje te një “ditë bankare”, kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat ndërkombëtare në Frankfurt am Main janë të hapura për punë të përgjithshme.

14.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje është Frankfurti am Main.

14.3 Pavlefshmëria e pjeshme dhe boshllëqet. Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje huaje është ose bëhet e pavlefshme, ose ka një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje, kjo nuk ndikon vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Palët në këtë marrëveshje zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një të vlefshme ligjërishit që është sa më afër sa është e mundur me frymën dhe qëllimin e dispozitës së pavlefshme. Palët mbushin çdo boshllëk në dispozitat me një dispozitë ligjërishit të vlefshme që është sa më afër sa është e mundur me frymën dhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

14.4 Forma me shkrim. Ndryshimet dhe shtesat në këtë marrëveshje duhet të bëhen me shkrim për të qenë të efektshme. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë me formë me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim.

14.5 Transferimi. Huamarrësi nuk mund të transferojë, rëndojë me peng ose hipotekë çdo pretendim nga kjo marrëveshje.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji gjerman.

14.7 Periudha e parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj marrëveshjeje parashkruhen pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilën ky pretendim ka lindur dhe në të cilën KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të kishte ardhur në dijeni të tyre pa neglizhencë të theksuar.

14.8 Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhen vetëm dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, zbatohet sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me rregullat e arbitrazhit të dhomës ndërkombëtare të tregtisë (ICC) të ndryshuar herë pas here.

b) Gjykimi në arbitrazh zhvillohet në Frankfurt am Main. Gjykimi zhvillohet në gjuhën angleze.

14.9 Transmetimi i informacionit. KfW-ja ka të drejtë t'i transmetojë Republikës Federale Gjermane informacion në lidhje me përfundimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. KfW-ja dhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtë të kalojnë informacionin në lidhje me huan dhe programin duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja organizatave ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me çështjet për shërbimin e borxhit. E drejta e mësipërme për dhënien e informacionit organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për të kaluar drejtpërdrejt këtë informacion anëtarëve të këtyre organizatave.

14.10 Hyrja në fuqi. Kjo marrëveshje huaje dhe programi nuk hyn në fuqi derisa marrëveshja qeveritare mbi të cilën ajo bazohet të ketë hyrë në fuqi dhe Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që marrëveshja e programit dhe huas është ratifikuar dhe ratifikimi i saj është publikuar rregullisht.

Kjo marrëveshje huaje nënshkruhet në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main

Për KfW-në

Për Republikën e Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave

Për Ujësjellës-Kanalizime UK Pogradec sh.a.

ANEKSI 1

Shënim. Jeni të lutur të ndryshoni “Republika e VENDI” / “VENDI” përkatësisht.

MODEL I MENDIMIT LIGJOR TË KËSHILLTARIT LIGJOR PËR HUAMARRËSIN (SHTETI)

[Koka e letrës së këshilltarit ligjor]

KfW

(datë)

Departamenti []

Në vëmendje të: []

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main / Germany

Republika Federale Gjermane

Marrëveshje e huas datë dhe lidhur ndërmjet KfW-së (.....) (Huamarrësi) dhe (.....) për një shumë që nuk kalon në tërësi ___ 000 000 euro.

Të dashur zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë) (këshilltar ligjor i) (shef i departamentit ligjor) . . . (jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të Republika e VENDIT. Unë kam vepruar në këtë kapacitet në lidhje me marrëveshjen e huas (marrëveshja e huas), datë . . . , të bërë ndërmjet Huamarrësit, (. . .) dhe jush në lidhje me një hua që do të jepet prej jush Huamarrësit në një shumë që nuk kalon ___000.000 euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 Një kopje të nënshkruar autentike të marrëveshjes së huas;

1.2 Dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

1.2.1 Kushtetutën e Republikës së VENDIT, datë , publikuar rregullisht në , nr. , faqe. , e ndryshuar;

1.2.2 Ligji(et) nr datë , të publikuar rregullisht në , nr. , faqe. , e ndryshuar; (jeni të lutur të fusni, nëse ka, ligje (p.sh., ligjet e buxhetit) në lidhje me marrjen hua të parave nga Republika e VENDI);

1.2.3 [jeni të lutur t’u referoheni këtu dokumenteve të tjerë, p.sh., dekretave ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT në lidhje me lidhjen e marrëveshjeve të huave nga VENDI në përgjithësi ose në lidhje me lidhjen e marrëveshjes së huas); dhe

1.2.4 Marrëveshja e Bashkëpunimit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë datë (marrëveshja e bashkëpunimit)

Dhe ato ligje, rregullore, certifikata, regjistra, të dhëna dhe dokumente dhe janë bërë ato hetime të tjera që unë i kam menduar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij mendimi.

2. Mendim

Për qëllimin e nenit 8.1 të marrëveshjes së huas, unë jam i mendimit që sipas ligjeve të Republikës së VENDIT të kësaj date:

2.1 Në pajtim me nenin të Kushtetutës / nenit të ligjit nr (jeni të lutur të specifikoni sipas rastit) Huamarrësi ka të drejtë të lidhë marrëveshjen e huas dhe ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas, veçanërisht në bazë të:

2.1.1 Ligjit(eve) nr datë të parlamentit të Republikës së VENDIT, që ratifikon marrëveshjen e huas / aprovon nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi / (jeni të lutur të fusni sipas rastit);

2.1.2 Rezoluta(t) nr datë të Kabinetit të Ministrave / të komitetit të huave shtetërore / (jeni të lutur të fusni organet qeveritare ose administrative të VENDIT sipas rastit);

2.1.3 (jeni të lutur të fusni rezoluta, vendime të tjera etj.).

2.2 Zj/Z. (dhe Zj/Z.) është (janë) të autorizuar rregullisht nga (p.sh., ligji në sajë të pozicionit të tij/saj (si Ministër i si), nga rezoluta qeveritare., me prokurë të datës etj.) të nënshkruaj vetëm/bashkërisht marrëveshjen e huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e huas e nënshkruar nga Zj/Z (dhe Zj/Z.) është nënshkruar rregullisht nga ana e Huamarrësit dhe përbën një detyrim ligjërisht detyrues për Huamarrësin të ekzekutueshëm ndaj tij ligjërisht në pajtim me termat e saj.

(Alternativa 1 për seksionin 2.3, që përdoret nëse përveç dokumenteve të specifikuara në seksionin 2.1 dhe 2.2 duhet të merren autorizime të caktuara zyrtare sipas ligjeve të Republikës së VENDIT).

2.3 Për nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin te KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në bazë të saj në monedhat e specifikuara në të), janë marrë aprovimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e mëposhtme zyrtare dhe janë tërësisht në fuqi:

2.3.1 Aprovimi i (Banka Qendrore/Banka Kombëtare/.], datë, nr.;

2.3.2 Pëlqimi i Ministri / Ministria e], datë, nr.; dhe

2.3.3 (jeni të lutur të rendisni çdo autorizim, licencë dhe pëlqim tjetër zyrtar).

Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Zyrtare të Republikës së VENDIT) ose gjykate nuk kërkohet apo është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin te KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuara atje) dhe vlefshmëria dhe ekzekutueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.

(Alternativa 2 për seksionin 2.3, që përdoret vetëm nëse përveç dokumenteve të specifikuara në seksionin 2.1 dhe 2.2 asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së VENDIT).

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Zyrtare të Republikës së VENDIT) ose gjykate nuk kërkohet apo është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin te KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuara atje) dhe vlefshmëria dhe ekzekutueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.

2.4 Asnjë tatim vule ose tatim apo detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e marrëveshjes së huas.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar marrëveshjen e huas dhe paraqitjen për arbitrazh në pajtim me nenin 14.9 të marrëveshjes së huas janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit kundër Huamarrësit njihen dhe janë të ekzekutueshëm në Republikën e VENDIT në pajtim me rregullat e mëposhtëm: (jeni të lutur të fusni traktatin e zbatueshëm (sipas rastit),

p.sh., në vitin 1958 Konventa e Nju-Jorkut, dhe/ose parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në VEND).

2.6 Gjykatat e Republikës së VENDIT kanë të drejtën të japin vendime të përcaktuara në monedhën ose monedhat e specifikuara në marrëveshjen e huas.

Huamarrja nga Huamarrësi sipas marrëveshjes së huas, si dhe nënshkrimi dhe përmbushja e kontratës e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare dhe jo akte publike dhe qeveritare. As Huamarrësi dhe asnjë prej sendeve të tij nuk ka të drejtë imuniteti nga arbitrazhi, padia, përmbarimi, sekuestrimi ose veprime të tjera ligjore. Megjithatë, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti, në lidhje me përmbarimin, në lidhje me:

- “Ambientet e misionit” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike në vitin 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj;

- Një pasuri të paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr 8743, të datës 22/2/2001 “Mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore”;

- Çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe është paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike të nënshkruar prej saj.

2.7 Marrëveshja e bashkëpunimit është në fuqi të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së VENDIT (në pajtim me nenin 3 të marrëveshjes së bashkëpunimit) (si alternativë jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet e zbatueshme dhe rregulloret). Huamarrësit nuk i kërkohet të bëjë asnjë zbritje ose ndalesë nga pagesa që Huamarrësi duhet të bëhet sipas marrëveshjes së huas.

2.8 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me seli apo të zhvillojë biznes apo t’i nënshtrohet tatimit në Republikën e VENDIT thjesht për shkak të nënshkrimit, përmbushjes dhe ekzekutimit të marrëveshjes së huas. Nuk është e nevojshme apo e këshillueshme që KfW-ja të licencohet, kualifikohet apo të marrë të drejtë në mënyrë tjetër të zhvillojë biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë apo përfaqësues në Republikën e VENDIT.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe pa kusht, të ligjshme, të vlefshme dhe detyruar për Huamarrësin dhe janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me termat e tyre përkatëse.

Ky mendim ligjor kufizohet për ligjet e Republikës së VENDIT.

.....
(vendi)

.....
(data)

[Nënshkrimi]

Emri:

Bashkangjitur:

Shënim. Jeni të lutur të bashkëngjisni fotokopje të certifikuara të dokumenteve dhe dispozita ligjore të përmendura më sipër në seksionin 1.2 (a) deri 1.2(c) dhe seksionet 2.1 deri 2.6 (në lidhje me ligjet e gjata dhe Kushtetutën e Republikës së VENDIT, një kopje të dispozitave përkatëse duhet të jetë i mjaftueshëm) dhe t’i japë KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të secilës prej dokumenteve të sipërpërmendura nëse këto dokumente nuk janë lëshuar në anglisht ose gjermanisht si një gjuhë zyrtare.

MARRËVESHJA E FINANCIMIT DHE PROJEKTIT
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (PËRFITUESI) DHE UK
POGRADEC (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT) PËR 3,456,250 EURO
- PROGRAMI PËR MBROJTJEN MJEDISORE TË LIQENIT TË OHRIT, KANALIZIMET
POGRADEC, FAZA III

Mbi bazën e një marrëveshjeje të lidhur datë 11 gusht 2009 ndërmjet Komisionit Europian dhe KfW-së (marrëveshje kontributi), përfituesi, agjencia zbatuese e projektit dhe KfW-së nënshkruajnë marrëveshjen e mëposhtme të financimit dhe projektit.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i ofron përfituesit një kontribut financiar jo më pak se 3,456,250 euro.

Ky kontribut financiar nuk është i kompensueshëm, nëse nuk përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Përfituesi i ofron kontributin financiar të plotë agjencisë së zbatimit të projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit përdor kontributin financiar vetëm për financimin e fazës së parë të zbatimit të projektit “Mbrotjtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet Pogradec, faza III” (projekti), dhe kryesisht për të paguar kostot e këmbimit valutor. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-së përcaktojnë detajet e projektit dhe mallrat dhe shërbimet të cilat duhet të financohen nga kontributi financiar nga një marrëveshje e veçantë, e cila duhet të bihet dakord nga përfituesi.

1.3 Taksat dhe tarifat e tjera publike që duhet të përballohen nga përfituesi, agjencia e zbatimit të projektit ose konsulenti (duke përfshirë mbajtjen e taksës) dhe taksat e importit, nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Ofrimi i kontributit financiar për agjencinë e zbatimit të projektit

2.1 Përfituesi i ofron kontributin financiar agjencisë së zbatimit të projektit si grant të pakthyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, përfituesi do t'i japë KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Ofrimi i kontributit financiar nuk përbën përgjegjësi të agjencisë së zbatimit të projektit për KfW-në për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja disburson kontributin financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit. Me një marrëveshje të veçantë (për të cilën duhet të bjerë dakord dhe përfituesi), agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-së përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti të dhënat që provojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimet e caktuara.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të bëjë disbursime pas datës 31.12.2015

Neni 4

Pezullimi i disbursimit dhe shlyerjes

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursime përveç nëse:

a) Përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të bërë pagesa, kur ato bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje, sipas marrëveshjes së huas dhe projektit nënshkruar me _____ ose marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë marrëveshje; janë shkelur,

c) Agjencia e zbatimit të projektit nuk është e aftë të provojë se kontributi financiar është përdorur për qëllimin e caktuar; ose

d) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit;

e) Nëse Komisioni Europian i kërkon KfW-së të pezullojë disbursimet.

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të përcaktuara në nenin 4.1 b) ose c) dhe nuk është zgjidhur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që, gjithsesi, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) Në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) Në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave kur agjencia e zbatimit të projektit nuk është e aftë të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 5

Kostot dhe tarifat publike

Përfituesi përballon të gjitha taksat dhe tarifat e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me nënshkrimin dhe ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shkaktohen në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe personat e caktuar nga ai/ajo në KfW dhe të autorizuar nga modele nënshkrimesh të vërtetuara nga ai/ajo, përfaqësojnë përfituesin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Drejtori i Ujësullës të Pogradecit dhe personat e caktuar nga ai/ajo në KfW dhe të autorizuar nga modele nënshkrimesh të vërtetuara nga ai/ajo, përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Prokurat nuk do të skadojnë deri në anulimin e tyre përfundimtar nga përfaqësuesi i autorizuar në kohën që janë marrë nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat në këtë marrëveshje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë do të jetë marrë nëse është dërguar në adresën e mëposhtme të autoritetit kontraktues përkatës ose në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i njoftohet palës tjetër kontraktuese.

Për përfituesin:

Ministria e Financave
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit” nr.1
Tirana
Republika e Shqipërisë
Faks: +355 42 22 8494

Për KfW-në:

KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Faks: +49 69 7431-2944

Për agjencinë zbatuese të projektit

Ujësjellës-Kanalizime
UK Pogradec sh.a.
Rruga e Buçimasit
Pogradec
Albania
Fax: + +355 868-20234

6.3 Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe përfituesit nuk kërkojnë aprovimin e agjencisë së zbatimit të projektit.

Neni 7 Projekti

7.1 Agjencia e zbatimit të projektit

a) Përgatit, zbaton, operon dhe mirëmban projektin në përputhje me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e projektit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) Cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit për inxhinierët konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e projektit për firmat e kualifikuara;

c) Lidh kontrata për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar pas ofertimit konkurrues paraprak ndërkombëtar;

d) Mban ose kujdeset drejtpërdrejt për mbajtjen e librave dhe regjistrave që deklarohen të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

e) I mundëson në çdo kohë përfaqësuesve të KfW-së, Komisionit Europian dhe/ose Delegacionit të Komisionit Europian në Republikën e Shqipërisë të inspektojnë librat dhe regjistrat e lartpërmendur dhe ndonjë dhe të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e projektit, dhe të vizitojnë projektin dhe të gjitha njësitë e lidhura me të;

f) I jep KfW-së ndonjë dhe të gjithë këtë informacion dhe regjistra për projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme që mund të kërkojë KfW-ja. Përfituesi është në dijeni të së drejtës së Komisionit Europian për të përdorur pa komisione të gjitha dokumentet që janë financuar nga kontributi financiar;

g) Do të sigurojë që çdo publikim ose informacion tjetër promociional për projektin do të përfshijë referencat e faktit që projekti bashkëfinancohet nga Komisioni Europian dhe të mbajë logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdha në një fushë blu); dhe

h) Të sigurojë që për një periudhë 5-vjeçare mbasi projekti të ketë përfunduar, Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Audituesve do të jenë në gjendje të bëjnë auditimin e nevojshëm për të verifikuar përdorimin e kontributit financiar bazuar në dokumentet dhe në vendet duke përfshirë të gjitha kontratat dhe nënkontratat, të cilat janë financuar nga kontributi financiar. Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Auditorëve kanë të drejtë të dërgojnë agjentet e tyre nëpër vende për të bërë inspektime siç përcaktohet në rregullore (EC, Euratom nr. 2185/1996).

7.2 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet në lidhje me nenin 7.1 me anë të një marrëveshjeje të veçantë që duhet të bihet dakord nga përfituesi.

7.3 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) Garantojnë financimin e plotë të projektit dhe sipas kërkesës, i japin KfW-së të dhëna që provojnë se kostot e papaguara nga ky kontribut financiar janë mbuluar, dhe

b) Me pëlqimin e tyre informojnë menjëherë KfW-në për ndonjë dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

7.4 Përfituesi i përfaqësuar ndihmon agjencinë e zbatimit të projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit sipas kësaj marrëveshjeje dhe në veçanti i jep agjencisë së zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

Neni 8
Dispozita të ndryshme

8.1 Agjencia e zbatimit të projektit garanton që personat përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, lidhjen e kontratave për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen dhe kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar, nuk kërkojnë, pretendojnë, japin, dhurojnë, premtojnë ose u premtohen pagesa të paligjshme ose përfitime të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit vënë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW kërkon të përmbushë detyrimet e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me përfituesin dhe agjencinë e zbatimit të projektit, që është e nevojshme për këtë qëllim.

8.3 Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në këtë drejtim. Çdo boshllëk rezultues do të plotësohet nga një dispozitë e pajtueshme me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të caktojë, ose transferojë, lërë peng ose zotohet për ndonjë pretendim nga kjo marrëveshjeje.

8.5 Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së, përfituesit dhe agjencisë së zbatimit të projektit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes funksionale të projektit, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

8.7 Kjo marrëveshje financimi hyn në fuqi pasi të jenë plotësuar nga ana e përfituesit të gjitha procedurat ligjore të brendshme. Përfituesi në këtë rast do të njoftojë menjëherë KfW.

Bërë në 2 origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
Kjo @ ditë @, 2010
KfW

Tiranë,
Kjo @ ditë @, 2010
Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar
nga Ministria e Financave

Tiranë,
Kjo @ ditë @, 2010
UK Pogradec

Ujësjiellës-Kanalizime
UK Pogradec sh.a.
Rruga e Buçimasit
AL-Pogradec
Republika e Shqipërisë
Fax: +355 86 82 02 34

Nicole Jonas
our ref.: jonn
phone: 49 69 7431 4667
e-mail: Nicole.Jonas@kfw.de
Date:

- L 3/a4 Marrëveshje e Bashkëpunimit Financiar Gjermani-Shqipëri
Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit
Kanalizimet Pogradec, faza III
13,456,250 euro
Nr.: BMZ-nr. 2008 65 204
Marrëveshja e veçantë e marrëveshjes së huas dhe projektit dhe marrëveshjes së financimit dhe projektit nënshkruar më _____

I/e nderuar zotëri ose zonjë

Në pajtim me marrëveshjen e huas dhe të projektit dhe marrëveshjes së financimit dhe projektit, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi), UK POGRADEC (agjencia ekzekutuese e projektit) dhe KfW-së (KfW) të datës ____ sa më poshtë, përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2 të marrëveshjes së huas dhe të projektit dhe marrëveshjes së financimit dhe projektit:

Hollësitë e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja;

Në pajtim me nenin 3.2 të marrëveshjes së huas dhe projektit dhe nenin 3.1 të marrëveshjes së financimit dhe projektit:

Procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë që shumat e disbursuara të huas përdoren për qëllimin e parashikuar;

Në pajtim me nenin 11.2 të marrëveshjes së huas dhe projektit dhe nenin 7.2 të marrëveshjes së financimit dhe projektit:

Hollësitë që i përkasin nenit 11.1 të marrëveshjes së huas dhe projektit dhe nenit 7.1 të marrëveshjes së financimit dhe projektit (zbatimi i projektit).

Ne propozojmë që të bihet dakord për sa më poshtë:

I. Dizenjimi i projektit

1. Detajet e projektit

Faza III e projektit konsiston në kanalizimet e Pogradecit dhe përfshin shtimin e impianteve të pastrimit dhe trajtimit të ujërave të zeza të Pogradecit në ndërtuara në fazën I, shtimin e lidhjeve të mëtejshme të sistemeve të pastrimit në jugperëndim dhe lindje të Pogradecit të ndërtuara, gjithashtu, në fazën I, rehabilitimin dhe ndërtimin e gropave septike, si dhe të pajisjeve të kanaleve sikurse eliminimi i fosforit nga kimikatet e shtuara. Gjithashtu, furnizimi me ujë të pijshëm në fshatrat e Gurrasit, Rremenj dhe Verdovë do të përmirësohet nëpërmjet rehabilitimit të masave ekzistuese. Qëllimi i projektit është menaxhimi i ujërave të zeza dhe pastrimi në qytetin e Pogradecit dhe në fshatrat që e rrethojnë duke mos cenuar ambientin dhe higjienën e vendbanimeve dhe furnizimin e vazhdueshëm me ujë të pijshëm dhe nga ana e higjienës të padëmshëm në Verdovë, Rremenj dhe Gurras. Kjo bëhet për të kontribuar në mbrojtjen e ujit të liqenit të Ohrit dhe për të reduktuar rreziqet shëndetësore për popullsinë e Pogradecit dhe fshatrave rrotull. Kriteret për të arritur këto objektiva, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit sikurse supozimet themelore të qëllimit të projektit dhe rezultatet e projektit janë të shpjeguara në aneksin I.

Dizenjimi i projektit bazohet në dokumentin “Raporti i ekspertëve për përgatitjen e projektit të një komponenti të kanalizimeve - faza III” përgatitur nga T. Neugebauer në shtator 2009 dhe “Projekti i furnizimit me ujë të Pogradecit, identifikimi i masave të projektit - faza III, i përgatitur nga L.Oppermann në qershor 2009, të cilat janë të vlefshme për KfW-në dhe agjencinë ekzekutuese të projektit dhe në marrëveshjet e bëra ndërmjet KfW-së dhe agjencinë ekzekutuese të projektit gjatë

misionit të vlerësimit në Tiranë më 6 korrik 2009, të përcaktuara në minutat respektive të takimit. Në rastin e ndonjë konflikti ndërmjet tekstit të minutave të takimit dhe tekstit të marrëveshjes së veçantë, teksti i marrëveshjes së veçantë do të mbizotërojë.

Aktivitetet e mëposhtme të projektit do të financohen nga huaja dhe kontributi financiar (gjenden, gjithashtu, dhe në aneksin 2):

- Zgjerimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Pogradec për lidhje të mëtejshme të jugperëndimit dhe lindjes së Pogradecit;

- Rehabilitimi i gropave ekzistuese të fekaleve dhe ndërtimi i të rejave në Buçimas, Verdovë, Remenj dhe Gurras;

- Zgjerimi i impiantit ekzistues të përpunimit të ujërave të zeza në gjithsej 50.000 banorë trajtim mekanik, 37.500 banorë trajtim biologjik;

- Kamion thithës dhe kamionin e ujërave të zeza;

- Pajisje mbrojtëse për sistemin e ujërave të zeza;

- Lëndë kimike për të realizuar eliminimin e fosforit (*iron salt*)

- Rehabilitimin e rezervuarit në Remenj, ndërtimin e një rezervuari të ri në Gurras;

- Rehabilitimin dhe shtimin e rrjetit të shpërndarjes në Rremenj dhe Gurras;

- Lidhja e re e shtëpive përfshirë metrat e ujit;

- Gjetja e burimeve dhe stacioni i pompave në Gurras; (Spring capture and pump station in Gurras)

- Rehabilitimi i rrjeteve kryesore të shpërndarjes në Gështenjas;

- Reduktimi i masave të presionit;

- Shërbimet e konsulencës.

2. Grafiku kohor

Grafiku kohor përkatës për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e projektit gjendet në aneksin

3. Zbatimi i projektit do të nisë kur UK Pogradec të ketë përmbushur marrëveshjet speciale të zbatimit (gjenden në paragrafin 4).

3. Kostoja e përgjithshme dhe financimi

Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit (kostoja e përgjithshme) ku mbështetet vlerësimi i projektit është afërsisht 13.456 milionë euro (përfshijë TVSH-ja, taksa, detyrimeve të importit, të cilat kanë lindur nga huamarrësi).

Shuma e huas është 10 milionë euro. Pjesa e mbetur 3.456 milionë euro do të financohet nga fondet IPF/MW. Përbërja e koston totale dhe planit të financimit gjenden në aneksin 4. KfW-ja hollësisht qartëson barrat financiare për agjencinë ekzekutuese të projektit të shkaktuara nga kjo hua dhe të nevojitura për një kontroll të fortë për kostot sikurse për të optimizuar veprimet (të pallogaritura për reduktimin e ujit) nëpërmjet agjencisë ekzekutuese të projektit me qëllim që të paguajë shërbimin e borxhit. Agjencia ekzekutuese e projektit do t'i dorëzojë huamarrësit parashikimin e disbursimeve të përpunuar në bashkëpunim të ngushtë me një konsulent zbatues. Kjo do të jetë e vlefshme për Huamarrësin çdo vit afati i fundit në nëntor për vitin e ardhshëm, me qëllim që të përmbledhë buxhetin e shumës së pritur të rimbursimeve VAT.

4. Ndryshimet në dizenjion e projektit

Çdo ndryshim i konsiderueshëm në dizenjion e projektit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Agjencia e zbatimit të projektit informon KfW-në për këtë menjëherë, duke deklaruar shkaqet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimeve (duke përfshirë koston e përgjithshme). Zbatimi i këtyre masave fillon vetëm mbi bazën e planit të rishikimit dhe me pëlqimin e KfW-së.

II. Zbatimi i projektit

1. Përgjegjësitë dhe koha, kostoja dhe grafiku i financimit

1.1 Agjencia zbatuese e projektit është përgjegjëse për zbatimin e projektit.

1. Afatet, kostoja e detajuar dhe grafiku i financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e përshtatshëm teknik dhe financiar të projektit, përgatitet sa më shpejt të jetë e mundur nga agjencia zbatuese e projektit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik tregon, me afate dhe shuma, ndërlidhjen e parashikuar kronologjike të aktiviteteve të projektit dhe kërkesat

përkatëse financiare. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të projektit, KfW-së i jepet një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i konsulentit

2.1 Detyrat e konsulentit do të përfshijnë planifikimin e detajuar të masave të investimit, tenderimit, duke përfshirë kontraktimin dhe ndërtimin, si dhe mbikëqyrjen gjithashtu të buxhetit dhe kontrollit të kostove dhe përgatitjes së kërkesave për disbursim.

2.2 Në vijim të parakualifikimit dhe ofertimit publik ndërkombëtar, kontrata do t'i jepet një konsulentit të kualifikuar të pavarur. Procedura e dhënies së kontratës do të udhëhiqet nga "Manuali për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 5), e cila formon një pjesë integrale të këtij manuali.

2.3 Në njoftimin e parakualifikimit agjencia ekzekutuese e projektit do të detyrojë ofertuesit të paraqesin së bashku dokumentet e ofertave së bashku me një ofertë të re të ekzekutuar përkatësisht nga një deklaratë mirëkuptimi (aneksi 4, faqe 16).

2.4 Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që përzgjedhja e ofertuesve, në përputhje me faktorët e tyre, do të jetë subjekt verifikimi nga Bashkimi Europian (EU) bazuar në sistemin e brendshëm paralajmërues të EU.

2.5 Agjencia ekzekutuese e projektit do të asistohet në përzgjedhjen e konsulentëve dhe do të japë kontratën nga një agjent tenderimi. Kjo asistencë do të financohet nga një fond special i dhënë nga Qeveria Gjermane (SBF-FUND).

2.6 Agjencia zbatuese e projektit do t'i sigurojë agjentit të tenderit, sikurse konsulentit zbatues të gjitha shërbimet e nevojshme gjatë vlerësimit të tenderit në Pogradec.

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera jepet në bashkëpunim me konsulentin dhe me ofertë ndërkombëtare konkurruese.

Tenderimi do të bëhet me 4 hapa si më poshtë:

- Hapi 1: Masa të furnizimit me ujë, si dhe për zgjerimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza (kontrata e çmimit të njësisë, sipas listës së kuqe FIDIC);

- Hapi 2: Kanale të shkarkimit të ujërave të zeza (kontrata e çmimit të njësisë sipas listës së kuqe FIDIC);

- Hapi 3: Impiantet (kontrata mallrash);

- Hapi 4: Lëndë kimike për realizimin e eliminimit të fosforit (kontrata mallrash);

Rehabilitimi ose ndërtimi i gropave të fekaleve do të kryhen nga UK Pogradec nën përgjegjësinë e vet.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për komente dhe dhënien e moskundërshtimit në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender. Raportet e vlerësimit të tenderit do t'i paraqiten KfW-së për komente përpara përfundimit të kontratës.

3.3 Afati i tenderit përcaktohet në një mënyrë që u jep ofertuesve kohën e mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Hollësitë e mëtejshme në lidhje me procedurën e dhënies dhe dispozitat kontraktuale shpjegohen në "Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punës sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 5), që përbën një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

3.5 Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë përzgjedhëse për ofertuesit midis faktorëve të tyre subjekt verifikimi nga Bashkimi Europian (EU) bazuar në sistemin e brendshëm të paralajmërimit (EU).

3.6 Në njoftimin e para-kualifikimit agjencia e zbatimit të projektit i detyron ofertuesit për të paraqitur së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën një deklaratë sipërmarrjeje (aneksi 5, faqe 27).

3.7 Gjatë lidhjes së kontratave për mallra dhe shërbime që financohen nga huaja dhe kontributi financiar, agjencia e zbatimit të projektit respekton, gjithashtu, parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse asnjë tarifë importi nuk financohet nga huaja ose kontributi financiar në pajtim me nenin 1.3 të marrëveshjes së huas dhe projektit dhe nenit 1.3 të marrëveshjes së financimit dhe projektit, këto tarifa importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, shprehen veçmas në kontratat për

mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Pagesat e kërkueshme sipas kontratave të mallrave dhe shërbimeve duhet të bëhen nga huaja dhe kontributi financiar, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që parashikon që çdo rimbursim, garanci ose pagesë tjetër e kërkueshme e ngjashme dhe çdo pagesa siguracioni bëhen për llogari të agjencisë së zbatimit të projektit në llogarinë nr. 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) at KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato dërgohen në një llogari të veçantë të agjencisë së zbatimit të projektit në vendin e agjencisë së zbatimit të projektit, që mund të tërhiqet vetëm me pëlqimin e KfW-së. Këto fonde mund të realizohen për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.8 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i paraqitet për mendim projekt kontrata siç është rënë dakord, e paraqitur rregullisht me pëlqimin e konsulentëve. E njëjta zbatohet për çdo marrëveshje të mëvonshme ndryshuese ose modifikuese.

4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 Agjencia zbatuese e projektit do të krijojë një grup pune permanent të kualifikuar për të përgatitur një planveprimi (UFF) vetëm për reduktimin e humbjeve të mëdha të ujit. Në një nivel të pranueshëm më pak se 30% dhe ta zbatojë respektivisht këtë planveprimi.

4.2 Për shkak të humbjeve të mëdha, agjencia zbatuese e projektit do të raportojë KfW-në deri në një njoftim të ri çdo muaj dhe çdo tre muaj për përmirësimet e bëra për reduktimin dhe administrimin teknik të humbjeve të ujit, si dhe do të japë sasi të përkatëse të ujit të prodhuar dhe të shitur në përputhje me IWA balancën standarde të ujit.

4.3 Autorizimi i konsulentit të tenderit do të bëhet vetëm kur agjencia zbatuese e projektit mund të dokumentojë në mesataren tremujore të humbjes së ujit 50% (uji pa të ardhura sipas IWA praktikës më të mirë të balancës standarde të ujit).

4.4 Tenderi për kontratat e mallrave dhe shërbimeve do të bëhet vetëm nëse agjencia ekzekutuese e projektit do të mund të dokumentojë mesataren tremujore një kuote të humbjes së ujit 40% (uji pa të ardhura sipas IWA praktikës më të mirë të balancës standarde të ujit).

4.5 Agjencia zbatuese e projektit do të:

- Rritja vjetore e tarifave të ujit të paktën 20% për vitet 2010 - 2012;

- Realizimi 100% i mbulimit të kostos duke përfshirë shërbimin e borxhit nga dhjetori 2011.

5. Dispozitat për operimin e përshtatshëm të projektit

5.1 Për të garantuar operimin e përshtatshëm të projektit, agjencia e zbatimit të projektit paraqet një koncept për operimin dhe mirëmbajtjen të përpiluar në bashkëpunim me konsulentin të paktën 3 muaj para autorizimit të projektit.

5.2 Në të njëjtën kohë, agjencia e zbatimit të projektit i paraqet KfW-së dhe Huamarrësit një parashikim financiar, të përpiluar në bashkëpunim me konsulentin, për sferën e operimit ku gjendet projekti. Ky parashikim është për të treguar që është siguruar financimi i operimit të projektit. Agjencia e zbatimit të projektit përditëson në mënyrë periodike këtë parashikim dhe siguron që çdo boshllëk financiar mbulohet në kohën e duhur. Agjencia e zbatimit të projektit ia transmeton këtë parashikim financiar dhe versionet e tij të rishikuara KfW-së dhe Huamarrësit pa vonesë.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që financohen nga huaja dhe kontributi financiar përgatitet mbi bazën e kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Për pasojë, KfW-së i jepet origjinali ose një kopje e secilës prej kontratave dhe e çdo kontrate ndryshuese përkatëse.

1.2 Nëse një masë e projektit të zbatohet me përgjegjësi (parashikimi dhe rehabilitimi dhe ndërtimi i gropave të fekaleve) dhe nuk ka asnjë marrëveshje paraprake, KfW-ja merr, në mungesë të kontratave, një grafik të masave të planifikuara, të detajuara në kategoritë kryesore të kostos (grafiku i masave pa marrëveshje paraprake). Kostot e shkaktuara për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punën pa marrëveshje paraprake nuk duhet të përfshihet në grafikun përkatës të masave pa marrëveshje paraprake.

1.3 KfW-ja informon me kërkesë agjencinë e zbatimit të projektit për shumat e huas dhe kontributin financiar që ajo ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

2. Procedurat e disbursimit

2.1 Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas parashikimit në aneksin nr.6, që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian do të rregullohet sipas (IPF/MW) do të përdoret për të financuar kontratat që janë dhënë mbas ofertimit krahasues ndërkombëtar. Pagesat sipas këtyre kontratave do të disbursohen nga kontributi financiar të siguar nga Bashkimi Europian dhe huaja të siguar nga Bashkëpunimi Financiar Gjerman për këto kontrata.

3. Përzgjedhja e audituesit

3.1 Projektit do t'i bëhet një raport vjetor auditimi për përdorimin e kontributit financiar të siguar nga Bashkimi Europian (auditor).

3.2 Audituesi do të përzgjidhet në përputhje mbas (kufizimit) ofertimit krahasues ndërkombëtar nga agjencia zbatuese e projektit dhe çdo vit do të vërtetohet përdorimi i kontributit financiar i siguar nga Bashkimi Europian deri në përfundim të projektit. Audituesi do të financohet nga kontributi financiar i siguar nga Bashkimi Europian.

3.3 Nëse është e nevojshme agjencia zbatuese e projektit mund të asistohet në përzgjedhjen e audituesit dhe dhënien e kontratës nga agjenti i tenderimit. Kjo asistencë do të financohet nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian.

3.4 Dokumentet e tenderit do të përfshijnë deklaratën që pranueshmëria e ofertuesve midis faktorëve të tyre do të jetë subjekt verifikimi nga Bashkimi Europian (EU) bazuar në sistemin e brendshëm të lajmërimit EU.

3.5 Termet e referencës së audituesit do të bazohen në termat standarde të referencës, siç janë bashkëngjitur në aneksin 7.

IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

1. Raportimi

1.1 Nëse nuk parashikohet ndryshe, agjencia e zbatimit të projektit i raporton KfW-së në çdo tre muaj mbi përparimin e projektit (raportet e progresit), duke përfshirë përmblidhjen e marrëveshjeve të zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të kësaj marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të rëndësishme dhe të përgjithshme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 8. Përveç kësaj, agjencia e zbatimit të projektit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimin e projektit dhe rezultatet. Në momentin e përfundimit fizik dhe komisionimit të projektit, por jo më vonë se skadimi i periudhës së garancisë, agjencia e zbatimit të projektit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e zbatuara. Raporti i parë mbi gjendjen e punëve paraqitet deri në 30 qershor 2011. Raportet duhet të jenë marrë nga KfW-ja jo më vonë se 2 javë pas përfundimit të periudhës së shqyrtimit. Raportet duhet të kundërfirmohen nga konsulenti.

1.2 Nëse agjencia e zbatimit të projektit ka ngarkuar konsulentin të shkruajë raportin e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, agjencia e zbatimit të projektit komenton mbi raportet ose njeh aprovimin e përmbajtjes nëpërmjet siglimit të raporteve.

1.3 Pas përfundimit të projektit, agjencia e zbatimit të projektit raporton mbi zhvillimin e saj të mëtejshëm (shih aneksin 2 për hollësi). KfW-ja informon në kohën e duhur agjencinë e zbatimit të projektit mbi përfundimin e periudhës së raportimit.

2. Dispozita të tjera

2.1 Agjencia e zbatimit të projektit i dërgon KfW-së të gjitha ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në të bëjë komente dhe japë aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëngjitura në momentin për të dhënë kohë të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Agjencia e zbatimit të projektit do të vendosë tabela me shenjat e projektit që do të përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

“Një projekt zhvillimi i Republikës së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së”.

2.3 Agjencia zbatuese e projektit do të sigurohet që i gjithë dokumentacioni i lidhur me përgatitjen dhe zbatimin e projektit do të jetë në dispozicion të audituesve deri në 5 vjet pas përfundimit të projektit. Agjencia zbatuese e projektit, gjithashtu, do të sigurohet që Komisioni European ose përfaqësuesit e tij do të jenë të gatshëm të bëjnë vlerësimin e projektit përpara, pas ose gjatë zbatimit të tij.

Një vulë projekti e dhënë nga Ambasada Gjermane dhe logo europiane (12 yje të verdhë në një fushë blu) do të vendoset mbi tabelën e shenjës së projektit.

2.4 Çdo pajisje e prokuruar nga konsulenti për projektin do t'i transferohet agjencisë zbatuese të projektit pas përfundimit të projektit. Dokumentacionet për transfertat do të mbahen nga agjencia zbatuese e projektit deri në 5 vjet pas përfundimit të projektit.

2.5 Agjencia zbatuese e projektit do të sigurohet që të gjitha dokumentet e përgatitura nga konsulenti duhet të përfshijnë një referencë të faktit që projekti bashkëfinancohet nga Bashkimi European dhe të ekspozojë logon europiane (12 yje të verdhë në një fushë blu). E njëjta gjë të aplikohet tek automjetet dhe pajisjet, të cilat janë prokuruar nga konsulenti për projektin deri sa t'i transferohen agjencisë zbatuese të projektit pas përfundimit të projektit.

2.6 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me marrëveshje reciproke nëse kjo do të duket e dobishme për zbatimin e projektit ose zbatimin e marrëveshjes së huas dhe projektit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e nenit 7.3 dhe 9 të marrëveshjes së huas dhe projektit do të zbatohen përkatësisht për këtë marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme duke nënshkruar në një formë ligjërishit të detyrueshme dhe duke kthyer kopjet e bashkangjitura.

Jeni të lutur t'i paraqisni konsulentit në kohën e duhur një kopje të kësaj marrëveshjeje.

Juaji sinqerisht,
KfW

Anekset

- Aneks 1: Objektivat dhe rezultatet e projektit dhe prezumimet për arritjen e tyre
- Aneks 2: Grafiku kohor
- Aneks 3: Kostoja dhe financimi i përgjithshëm
- Aneks 4: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim (FI 050)
- Aneks 5: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punës sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim (FI051)
- Aneks 6: Procedura e disbursimit
- Aneks 7: Shembull: termat e referencës për audituesin
- Aneks 8: Përmbajtja dhe forma e raportimit.

Lexuar dhe rënë dakord:


Për KfW

Për UK Pogradec

Lexuar dhe rënë dakord

Për Ministrinë e Financave

Aneksi 1
LogFrame - Programi per Mbrojtjen Mjedisore Liqeni I Ohrit – Vend Shkarkimi I ujrave te zeza I



Masat e nevojshme per me shume se nje rezultat
 Shërbimi i konsulentit të zbatimit

Afati kohor i punimeve
Vendshkarkimi i ujërave të zeza Pogradec III

Nr.	Vorgangsname	2010				2011				2012				2013				2014				2015				
		Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
1	Faza përgatitore																									
2	Përzgjedhja e konsulentit të zbatimit																									
3	Faza e projektimit																									
4	Projekti i detajuar dhe dokumentet e tenderit																									
5	Tenderimi dhe dhënia e kontratës																									
6	Faza e ndërtimit (zbatimit)																									
7	Punimet e zbatuara																									
8	Punimet e mbetura																									
9	Periudha e garancisë së defekteve																									

Projekt: Zeitplan_BV
Datum: Di 22.06.10

Vorgang
Unterbrechung
In Arbeit

Meilenstein
Sammelvorgang
Projektsammelvorgang

Externe Vorgänge
Externer Meilenstein
Stichtag

KOSTOJA DHE FINANCIMI

Rezultatet/masat e projektit Aneksi 4	Kostoja	Financimi		
		Granti EU	Huaja e KfW-së	Kontributi i Qeverise Shqiptare
		Euro	Euro	Euro
A Furnizimi me ujë				
1. Furnizimi me ujë në zonën e Tushemishtit	1,500,000	345,000	1,155,000	
2. Furnizimi me ujë në zonën e Gurras	900,000	207,000	693,000	
B Rrjetet e kanalizimeve				
Zgjerimi i rrjeteve të kanalizimeve të ujërave të zeza në Pogradec	4,200,000	959,872	3,240,128	
4. Gropa septike për fshatrat	800,000	176,000	624,000	
5. Shtirirja e WWTP	2,250,000	495,000	1,755,000	
6. Lëndë Kimike për të realizuar eliminimin e fosforit	950,000	209,000	741,000	
7. Pajisje të ndërmarrjes	400,000	88,000	312,000	
Nëntotali	11,000,000	2,479,872	8,520,128	
C Të tjera				
Kontigjenca, auditimi për fondet EU	956,250	210,375	745,875	
Çmimi i shkallëzuar	300,000	66,000	234,000	
Kostoja totale e investimit	12,256,250	2,756,247	9,500,003	
D Konsulenti i zbatimit	1,200,000	700,000	500,000	
Totali	13,456,250	3,456,247	10,000,003	
VAT	2,691,250			2,691,250

Komponentët e investimeve financohen *pari passu* nga grantet EU (afërsisht 22,5%, deri 3,456,250 euro) dhe huaja e butë e KfW-së (afërsisht 77,5%, deri te 10,000,000 euro).

Devijimi i vogël prej 3 eurosh në shumën totale është shkaktuar si rezultat i gabimeve në sistem.

Kontigjenca do të jetë e vlefshme për të gjitha masat duke përfshirë dhe shërbimet e konsulencës.

ANEKSI 6

Punonjësi përgjegjës: Caroline Möller
Tel: +49 69 7431-3542
e-mail: caroline.moeller@KfW.de

PROCEDURA E DISBURSIMIT

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit me KfW-në
Emri i projektit/programit: Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, kanalizimet Pogradec
Faza III
10 milionë euro – hua
KfW - Reference nr.: 2008 65 204
3,456,250 euro – kontributi financiar (marrëveshja e delegacionit europian për fondet EU
IPF/MW)
KfW - Reference nr.: 2020 59 988

PROCEDURAT E DISBURSIMIT

1. HYRJE

Ky aneks parashikon procedurën e disbursimit për projektin/programin e sipërpërmendur. Marrëveshja e veçantë duke përfshirë këtë aneks i ofrohet të gjithë personelit të huamarrësit, marrësit ose agjencisë së zbatim të projektit/programit (pala e autorizuar) dhe çdo pale tjetër që është e përfshirë në disbursime.

KfW disburson huat dhe kontributet financiare të pashlyeshme (fondet) me kërkesë të palës së autorizuar në pajtim me progresin e projekteve/programit të financiar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ajo ka rezervuar për mallra dhe shërbime të caktuara mbi bazën e “marrëveshjes së veçantë” që i përkasin marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet përkatëse të rezervuara formojnë kështu kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja pasi të jenë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursimin.

2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

2.1 Të gjitha kërkesat për tërheqje:

- tregojnë numrin e referencës së KfW-së;
- numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme; dhe
- nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar kundrejt KfW-së dhe nga të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e firmave (shembull. Shih shtojcën A).

2.2 Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat origjinale për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë të shënuar si konfirmim faksi. KfW-ja përjashtohet nga pala e autorizuar nga çdo përgjegjësi për çdo dëm që rrjedh nga transmetimet e gabuara, për shkak, veçanërisht, të gabimeve në transmetim, abuzimeve, keqkuptimeve ose gabimeve.

2.3 Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga ajo e përcaktuar (monedha e huaj), KfW-ja debiton huamarrësin ose marrësin me ato shuma që është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastësishme.

2.4 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transmetuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse një vonesë shkaktohet nga KfW-ja, përgjegjësia e saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

3. Dispozita të veçanta

3.1 Pala e autorizuar është UK Pogradec.

3.2 Procedura që do të zbatohet

Fondet e caktuara për shërbimet e konsulencës dhe inxhinierike të përcaktuara në marrëveshjen e veçantë I.1 do të disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

Fondet e caktuara për rehabilitimin dhe ndërtimin e gropave septike në Buçimë, Verdovë, Remenj dhe Gurras siç specifikohen në marrëveshjen e veçantë I.1. + II.3.1 do të disbursohen në përputhje me procedurën e llogarisë speciale të fondit në dispozicion (Procedurës së fondit në dispozicion) (llogaria speciale). Masat/kontratat individuale që do të financohen nga fondi i dispozicionit nuk do ta tejkalojnë vlerën 350,000 euro ose ekuivalenten.

Masat/kontratat individuale nuk do të tejkalojnë vlerën 350,000 euro ose ekuivalenten dhe fondet e investimeve të mbetura, siç është specifikuar në marrëveshjen I.1. + II.3.1, të disbursuara në përputhje me procedurën e thjeshtëzuar të disbursimit direkt.

Kontributi financiar i siguruar nga Komisioni Europian (IPF/MW) do të përdoret vetëm për të financuar kontrata për mallra dhe shërbime që janë lidhur pas tenderit ndërkombëtar. Pagesat sipas këtyre kontratave do të disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i siguruar nga Bashkimi Europian dhe huaja e siguruar nga Bashkëpunimi Financiar Gjerman për këto kontrata.

3.3 Procedura e disbursimit direkt (konsulenti)

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë tërheqjeje duke cituar emrin e përfituesit dhe instruksionet e pagesës (të gjitha detajet e bankës) (shihni shtojcën D).

3.3.1 Dokumentet në mbështetje të kërkesës për tërheqje, sipas rastit:

- Kopje e faturës së konsulentit;
- Prova për bazën e parashikuar në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e rritjes së çmimit;
- Lista e shpenzimeve për koston e rimbursueshme që tregon datën, përshkrimin, çmimin, normën e këmbimit, të nënshkruar rregullisht nga konsulenti që tregon që informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

3.3.2 Dokumentet

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që përputhen me faturat duhet të mbahen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të mund të shihen në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të udhëzuara nga KfW-ja (p.sh., auditë) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuara nga KfW-ja.

3.4 Procedura e thjeshtëzuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë të tërheqjes të autorizuar rregullisht (nënshkrime të autorizuara) (shih shtojcën E), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet për pagesë (hollësitë e plota bankare) dhe një kopje bashkëngjitur të faturës së kontraktorit.

KfW-ja i disburson fondet për llogari të palës së autorizuar drejt kontraktorit të mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga KfW.

Siç është rënë dakord në kontratën e konsulencës, konsulenti do të sigurojë palën e autorizuar me një "certifikatë pagese" që konfirmon se të gjitha disbursimet janë bërë dhe të gjitha dokumentet e paraqitura (përfshirë garancitë) janë në përputhje me kushtet e kontratës dhe rregulloret standarde të KfW-së.

3.4.1 Dokumentet

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që përputhen me faturat duhet të mbahen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të mund të shihen në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të udhëzuara nga KfW-ja (p.sh., auditë) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuara nga KfW-ja.

3.5 Veprimet e fondit në dispozicionit (llogaria speciale)

Për qëllime të fondit në dispozicion një llogari speciale do të hapet për UK e Pogradecit (pala e autorizuar). Detajet do të përmbahen në artikullin 1 të dokumenteve bashkëngjitur, kushtet suplementare të KfW-së për pagesat sipas procedurave të fondit në dispozicion "kushtet shtesë" (shtojca B). Parakushtet për disbursime janë të përcaktuara në artikullin 2 të "kushteve shtesë".

Llogaria do të mbahet në euro dhe do të mbajë interesin. Në rast se do jetë e nevojshme të bëhen pagesa lokale nga një llogari lokale, kjo llogari do të mbahet si shtesë e llogarisë lokale speciale. Për të ndaluar humbjet në zhvlerësimin e monedhës, një herë në muaj nevojiten shpenzimet e planifikuara të lejueshme për t'u transferuar nga një nga llogaritë e mësipërme speciale te llogaria speciale e monedhës lokale.

3.5.1 Pala e autorizuar e instrukton KfW-në të hapë një depozitë fillestare (paradhënie) te llogaria e mbajtësit siç është rënë dakord, derisa shuma të mbulojë shpenzimet për 4 muaj. Shuma aktuale për t'u disbursuar është subjekt i paraqitjes së një parashikimi për shpenzimet e planifikuara nga pala e autorizuar për katër muajt e ardhshëm. Për plotësimin e llogarisë speciale, Pala e Autorizuar (nëse aplikohet që të kundërfirmoset nga pala e autorizuar) do të paraqesë evidencat së bashku me kërkesën që do të arsyetohet për plotësim pasi shpenzimet e së paku 50% të depozitës fillestare (kërkesa për plotësim, shihni modelin në shtojcën B/aneksi 3 “Kushtet shtesë”). Shuma që do të plotësohet do të jetë subjekt i prezantimit të parashikimit të ri të shpenzimeve për katër muajt e ardhshëm.

